



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE VLORE

Numri i Ceshtjes :	31003-00770-84-2016	Data e Regjistrimit :	04/04/2016
Numri i Vendimit:	84-2016-898	Data e Vendimit :	24/05/2016

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE VLORE E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Gentiana Xhelili

SEKRETARE: Gentiana Xhelili

Sot më datë 24/05/2016mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile që i përket :

Paditës Petraq Naci, i biri i dhe i , i datëlindjes 01/01/1960 I Paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier I Paditur Drejtoria e Apelimit tatimor Tirane

Objekti:Kunershtim i aktit administrativ Njoffim vleresimi per detyrimet tatimore nr. 26944 prot dt. 28.12.2015 gjobe.

Baza Ligjore:neni 31, 32/a K.Pr.C.

Gjykata, në seancën e datës 24.05.2016, konform nenit 25 të ligjit nr.49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative'

VEREN :

Se pala paditëse Petraq Naci i është drejtuar Gjykatës Administrative Rrethi Gjyqësor Vlorë me një padi me objektin e mësipërm. Gjykata pasi ka verifikuar aktet në dosje konform nenit 25 të ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative me vendim të ndërmjetëm datë 23.05.2016 gjykata ka vendosur ti caktojë një afat paditësit Petraq Naci për te paguar taksen gjyqësore duke i lënë si afat datën 24.05.2016, ora 09.45

Rezulton se pala paditëse nuk ka paguar taksen gjyqësore pasi ne seancen pregatitore nuk u paraqit.

Në nenin 21 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se:Padia duhet të plotësojë kërkesat e neneve 154 dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile , ku përfshihet dhe saktësimi i adreses se paleve ne gjykim.

Në nenin 25 të këtij ligji parashikohet se :

"Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë kryen këto veprime:

a) i kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë duke i cakuar atij një afat deri në 10 ditë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve,që i bashkëlidhen asaj. Kundër ketij vendimi lejohet ankim i veçantë.

Rezulton se paditësi nuk ka paguar taksen gjyqësore ne afatin e caktuar nga gjykata.

Gjykata, bazuar në nenin 127 të K.Pr.Civile, nenet 21 dhe 25 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimi ne gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' dhe nenit 154/adhe 156 të Kodit të Procedurës Civile,

Për këto arsve

Gjykata, bazuar në nenin 127 të K.Pr.Civile, nenet 21 dhe 25 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimi ne gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' dhe nenit 154/adhe 156 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Vendosi:Kthimin me te meta te kerkese padise me Nr. 916 akti date 04.04.2016 regjistrimime pale paditese Petraq Naci

2. Kunder vendimit lejohe ankim i vecante ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane brenda 5 diteve duke filluar ky afat nga dita e neserme e njoftimit te vendimit

3. U shpall ne Vlore sot me date 24.05.2016

SEKRETARE

EDLIRA SHEHU

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

Gentiana Xhelili